

1100 03.11.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

4260

Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 02.11.2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.117

Datë: 27.10.2023

“Për një ndryshim fondesh në Buxhetin e Qendrës Kulturore Dibër akorduar nga Këshilli i Qarkut Dibër”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim Mikli





4260/107/11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr:1100/1 prot.

Peshkopi, më 06.11.2023

Lënda: Për vendimin nr.117, datë 27.10.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.117, datë 27.10.2023 "Për një ndryshim fondesh në buxhetin e Qendrës Kulturore Dibër akorduar nga Këshilli i Qarkut Dibër", konstatova:

Miratimin në parim, si veprim i kategorive të tjera financiare, të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e financës e probleme të ngjashme me to, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër, që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre, të cilat në kuptim të nenit 13, pika 5, e ligjit nr.139/2015 "Pë Vetëqeverisjen Vendore", janë subjekte kontrolli nga KLSH-ja.

PREFEKTI
Nexhbedin SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr.117 Datë 27/ 10/ 2023

“ Për një ndryshim fondesh në Buxhetin e Qendrës Kulturore Dibër akorduar nga Këshilli i Qarkut Dibër”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, I ndryshuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.120 datë 22.12.2022, mbi detajimin e buxhetit të vitit 2023, I konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.19/1 prot, datë 11.01.2023, i ndryshuar, si dhe vendimin nr.22 datë 20.10.2023 të Këshillit të Qarkut Dibër “Për miratim ndryshim zërash buxhetor dhe transferim fondi për Bashkinë Dibër,(Qendra Kulturore Dibër), për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, konfirmim nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.1066/1 prot. datë 24.10.2023, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 27.10.2023, me 19 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të ardhur nga Këshilli i Qarkut Dibër për Qendrën Kulturore Dibër në vlerën prej 500.000 lekë për organizimin e eventeve si “Festa e Lurës” dhe “ Organizimin e Tetorit Rozë” në kuadër të sensibilizimit ndaj luftës kundër kancerit të gjirit”.

Të pakësohet:

Gr. 00 Tit. 1110 Kap. 5 Llogaria Ekonomike 604 500.000 lekë

Të shtohet:

Gr. 00 Tit. 8220 Kap. 5 Llogaria Ekonomike 602 500.000 lekë

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (sektori i financës) pranë Bashkisë Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë 27.10.2023.



BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i finances
PROJEKT - VENDIM
Nr. 15 Datë 25/10/2023

“Për një ndryshim fondesh në Buxhetin e Qendrës Kulturore Dibër akorduar nga Këshilli i Qarkut Dibër”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr. 120 datë 22.12.2022, mbi detajimin e buxhetit të vitit 2023 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 19/1 prot. datë 11.01.2023, i ndryshuar, si dhe vendimin nr. 22, datë 20.10.2023 të Këshillit të Qarkut Dibër “Për miratim ndryshim zërash buxhetor dhe transferim fondi për Bashkinë Dibër, (Qendra Kulturore Dibër), për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, konfirmim nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresë nr. 1066/1 prot. date 24.10.2023,

Kërkojmë:

- Miratimin e fondit të ardhur nga Këshilli i Qarkut Dibër për Qendrën Kulturore Dibër në vlerën prej 500,000 lekë për organizimin e eventeve si “Festa e Lurës” dhe “Organizimin e Tetorit Rozë” në kuadër të sensibilizimit ndaj luftës kundër kancerit të gjirit”.

Të pakësohet:

GR.00 Tit. 1110 Kap. 5 Llogaria ekonomike 604 500,000 lekë

Të shtohet:

GR.00 Tit. 8220 Kap. 5 Llogaria ekonomike 602 500,000 lekë

- Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (sektori i financës) pranë Bashkisë Dibër.
- Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR



P/S/Financës
Albjola SHAHI

Drejtori Ekonomik
Çiljeta ZUNA

P/S/Juridik
Ismet SARAÇI

Kryetari i Bashkisë
Rahim SPAHIU

Në mungesë dhe me porosi
Nën kryetari i Bashkisë
Ruzhdi DEDA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
QENDRA KULTURORE DIBËR

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr.tel. 00355 218 2 25 16

RELACION

Për organizimin e eventeve në kuadër të Tetorin Rozë

Ky projekt bëhet në sajë të "Tetorit Rozë" në kuadër të luftës kundër kancerit të gjirit.

Për organizimin e këtij eventit do të duhen:

1. Foni	20,000
2. Ndriçim	20,000
3. Shërbime mbështetëse	3x5,000 = 15,000
4. Spiker	10,000
5. Staf mbështetës	10,000
6. Banera dhe materiale promicionale	25,000

Gjithsej: 100,000 Lekë

16.17.18 Nëntor "FESTA E LURËS"

Për realizimin e këtij projekti është i domosdoshëm ekzekutimi dhe interpretimi i këngëve të ndryshme të zgjedhura nga udhëheqësi artistik në bashkëpunim me këngëtarët

dhe instrumentistët përkatës dhe interpretimi I këngëve dhe valleve të përzgjedhura nga udhëheqësi artistik dhe koreografi.

Ky projekt bëhet në sajë të promovimit të kulturës dhe vlerave artistike të Lurës dhe Dibrës.

Këngët që do të interpretohen janë:

Shpenzimet e mundshme

Për realizimin e këtij projekti grupi artistik do të përbëhet nga 36 persona dhe kostoja mund të jetë si më poshtë dhe sipas ligjit.

1. Foni	20,000
2. Transport	20,000
3. Shërbime mbështetëse	3x5,000 = 15,000
4. Spiker	10,000
5. Staf mbështetës	10,000
6. Banera dhe materiale promocionale	25,000
7. Valltarë	12 x 4,000 = 48,000
8. Këngëtarë	6 x 5,000 = 30,000
9. Instrumentistë profesionistë	4x12,000 = 48,000
10. Instrumentistë amator	6 x 7,000 = 42,000
11. Akomodim + Ushqim	36 persona = 132,000

Gjithsej: **400,000 Lekë**

Totali për të dy aktivitetet: **500,000 Lekë**

Në pritje të mbështetjes tuaj financiare!

Drejtori

Igli Tomçini

